

SHOQATA E KONTABILISTËVE DHE FINANCIERËVE TË SHQIPËRISË

Nr. 13/03-1 Prot.

Tiranë, më 13 Mars 2020

K Ë R K E S Ë

Drejtuar: Znj. Anila Denaj, Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Për dijeni: Znj. Delina Ibrahimaj, Drejtor i Përgjithshëm i DPT-së

Nga: Sherif Bundo, Kryetar i Shoqatës së Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë

Lënda: Kërkesë për shtyrjen e afateve të deklarimeve për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19

E nderuar Znj. Denaj

Situata e krijuar aktualisht pas përhapjes së virusit Covid-19 dhe masat e marra nga qeveria, ku një pjesë e mirë e punonjësve po qëndrojnë apo punojnë nga shtëpia, ka ngadalësuar ritmin e punës së kontabilistëve, si dhe ka krijuar vështirësi operative lidhur me hartimin dhe dorëzimin e pasqyrave financiare dhe deklaratave shoqëruese.

Të ndodhur në këto kushte anëtarët e shoqatës sonë (kontabël të miratuar) kërkojnë bashkëpunimin dhe mbështetjen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të lejuar shtyrjen e afatit të dorëzimit të:

- pasqyrave financiare për vitin 2019 deri në 30 Prill 2020, apo deri në një datë të mëvonshme në varësi të zhvillimeve në vend.

- deklaratës së tatim fitimit për vitin 2019 dhe pagesës së detyrimit përkatës (nëse ka) deri në 30 Prill 2020, apo deri në një datë të mëvonshme në varësi të zhvillimeve në vend. Ne besojmë, se shtyrja e afatit të pagesës së tatim fitimit do të ketë një efekt të vogël në buxhetin e shtetit, nisur nga fakti që pagesa e kësteve të tatim fitimit është kryer rregullisht nga subjektet dhe do të vijoj të kryhet.





SHOQATA E KONTABILISTEVE
DHE FINANCIEREVE TË SHQIPËRISE

- njoftimit të transaksioneve vjetore të kontrolluara për vitin 2019 deri në datë 30 Prill 2020, apo deri në një datë të mëvonshme në varësi të zhvillimeve në vend.

Ne besojmë se kjo është një kërkesë e arsyeshme në kushtet ku një pjesë e mirë e departamenteve të financës, si dhe kontabilistëve të jashtëm janë të detyruar apo të këshilluar të punojnë nga shtëpia, të punojnë në mënyrë të kufizuar, apo të mos punojnë, për të paktën dy javët në vijim.

Duke shpresuar në bashkëpunimin tuaj për të gjetur një zgjidhje të përbashkët, ne shprehim gatishmërinë tonë dhe mbetemi në pritje të komunikimit tuaj.

Me respekt,

Sherif BUNDO

Kryetar i Shoqatës së Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë

Andi Sukoç AS

